



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr 2226 prot.

Gramsh, më 28/05/2024

**MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17,56, 57 dhe “Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Gramsh”, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e dates 27 . 05 .2024:

**VENDOSI**

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Gramsh, e cila do të mbahet në datën 31.05.2024.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Gramsh, Deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Xhulia Gjini**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Epis Zani**





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK ✓  
GRAMSH

Nr 2226 prot.

Gramsh, më 28/05 /2024

**NJOFTIM**

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak;  
Të nderuar këshilltarë, Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për funksionimin e Këshillit Bashkiak Gramsh”, njoftoj se mbledhja e muajit MAJ do të zhvillohet ditën e PREMTE datë 31/05/2024 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit, me rend dite si më poshtë:

- 1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin PRILL 2024 (fondi 6%) (Sek. Ndh. Sociale).
- 2- Për dhënien e ndihmës financiare z. Adriatik Bitra. (Dr. Finances & Buxhetit).
- 3- Për dhënien e ndihmës financiare znj. Thëllënxë Llalla. (Dr. Finances & Buxhetit).
- 4- Për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afat-Mesëm 2025-2027. (Dr. Finances & Buxhetit).
- 5- Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027. (Dr. Finances & Buxhetit).
- 6- Për ndryshimin e orarit të linjës Gribë-Gramsh dhe Kukur - Gramsh. (Sek. të Ardhurave nga Biznesi & Transporti).
- 7- Miratimi i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 2024-2029, për Bashkinë Gramsh. (Nënkryetari)
- 8- Kërkesa të qytetarëve, Të tjera.

*Duke ju falenderuar!*

SEKRETARI I KËSHILLIT  
Xhulja GJINI

